



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 26.01.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, zëvendëskryetar i parë, Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë, Anton Quni, Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Skender Perteshi-QKSS, Ardiana Gashi-OSBE, Lumnije Murati-Zyra e presidentes së Kosovës dhe Krenare Loxhaj-QKSS.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 13.01.2015;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 13.01.2015

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtur më 13.01.2015.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2015

Kryetari- Theksoi se draft -planin e punës i cili u është paraqitur nuk është i pa ndryshueshëm dhe mund të plotësohet. Për këtë qëllim është paraparë edhe punëtorja e mbështetur nga OSBE-ja. Gjithashtu në bashkëpunim me stafin kam propozuar që, përpos projektligjeve të cilat janë paraparë në strategjinë legjislative për këtë vit, në plan të punës të jetë edhe Projektligji për komisionarin e FSK- së; dhe PK, i cili projektligj është draftuar nga Komisioni në legjislaturën e kaluar. Pastaj fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Fadil Demaku- Vlerësoi se drafti i planit të punës i përfshinë objektivat e Komisionit, ndërsa propozoi që meqë në disa muaj agjenda është më e ngarkuar do të ishte mirë të bëhej shpërndarja e aktiviteteve në muaj. Ndërsa sa i përket aktivitetit në muajin tetor, vizitë në veriun e Kosovës, kërkoi që të jetë më e precizuar dhe cili do të jetë qëllimi i kësaj vizite. Me që është paraparë punëtorja për këtë plan do të japim kontributin tonë për plotësimin tij dhe në përgjithësi pajtohet me këtë draft- plan të punës për vitin 2015.

Kryetari- Shtoi se arsyeja e kësaj vizite që është paraparë në veri të vendit tani është bërë një transformim i strukturave të sigurisë. Prandaj është paraparë që t'i bëhet një vizitë stacionit policor në veri të Kosovës, për t' i parë nga afër kushtet e punës etj.

Fadil Demaku- Pajtohem me këtë që theksoi kryetari dhe se kjo do të duhej të përfshihej në një plan- veprimi nga ana e stafit mbështetës. Ai gjithashtu propozoi që përpos Stacionit Policor të vizitohen edhe strukturat e tjera të sigurisë, të cilat mbulohen nga fushëveprimi i Komisionit.

Bojan Mitiq- Përsëriti të pranishmit, ndërsa sa i përket planit vjetor të punës vlerësoi se është përfshirë një plan i mirë dhe është i pranueshëm si i tillë. Gjithashtu në të ardhmen, nëse do të jetë e nevojshme, mund të plotësohet, ndërsa sa i përket punëtorisë e cila do të mbahet nesër, për shkaqe objektive nuk do të mund të marrë pjesë, ndërsa do të kontribuojë që të bëhet një punë e mirë.

Zafir Berisha- Vlerësoi se plani i punës për këtë vit, është rrjedhojë e përgjegjësisë që vinë nga rregullorja e punës së Kuvendit, ndërsa sa i përket njërit objektiv të Komisionit, për shkëmbimin e përvojave me komisionet homologe të parlamenteve të tjera, sipas këtij drafti është paraparë vetëm në Shqipëri, konsideroi se vizita në disa vende të tjera të rajonit, të cilat kanë pasur të

kaluara të përafërt, siç është Sllovenia, Kroacia dhe Mali i Zi, dhe shkëmbimi i përvojave me këto vende do të na shërbente shumë.

Kryetari- Shtoi se vizita do të planifikohet dhe do të bëhet përpjekje të realizohet, siç është në Gjermani ose Slloveni me mbështetje të organizatave që mbështesin Komisionin. Komisioni për katër vite nuk ka pasur takim formal në Shqipëri, por mbase tani Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe do të bëjmë përpjekje që të realizohen këto vizita.

Nuredin Ibishi- Pajtohem me Zafir Berishën që të merren praktikat më të mira të rajonit. Ai gjithashtu propozoi që të përfshinë edhe dëgjime publike të përbashkëta të komisioneve që mbulojnë fushën e sigurisë, dhe aktorët e sigurisë për një periudhë 3- 6 muaj, në mënyrë që të shihet se si funksionon sektori i sigurisë.

Qerim Bajrami- Theksoi se pajtohet në parim me këtë draft- plan të punës për vitin 2015, dhe propozoi që në të, të përfshihen më shumë vizita në vendet e rajonit, siç është Turqia, për çështje që lidhen me sigurinë dhe për ndihmën e Kosovës dhe për ushtrinë ardhshme të Kosovës. Gjithashtu dihet se kemi kadetët tanë që shkollohen në Maqedoni, dhe për këtë qëllim do të ishte mirë të kishim edhe një vizitë në këtë vend.

Ganimete Musliu- Parimisht e mbështet planin e punës, ndërsa kontributin do ta japë në punëtorinë e cila do të mbahet nesër për planin e punës. Ndërsa sa i përket vizitave jashtë vendit, theksoi se është fillimi i mandatit dhe në vazhdim do të kemi oferta nga vendet e rajonit dhe vendet evropiane.

Anton Quni- Mbështeti në parim planin punës për vitin 2015, me shpresën që në punëtorinë që do të mbahet të arrihet në një plan final.

Kryetari- Theksoi se ky draft- plan nuk është i pa ndryshueshëm dhe s' mund të plotësohet. Ndërsa për anëtarët që nuk do të mund të marrin pjesë në punëtori për planin e punës, kërkoi që në rast se kanë propozime të sillen me shkrim dhe ato do të mund të përfshihen në plan të punës.

4. Të ndryshme.

Kryetari- A keni çështje për të diskutuar në këtë pikë?

Fadil Demaku- Ngriti çështjen e Projektligjit për Përgjime, i cili në këtë legjislaturë i është adresuar Komisionit për Integritet dhe se ky projektligj nuk është votuar nga deputetët e Kuvendit. Gjithashtu theksoi se ky projektligj në legjislaturën e kaluar ka qenë në Komisionin për Siguri dhe në Komisionin për Mbikëqyrjen e AKI-së, ku nga ky Komision ka qenë udhëheqës i grupit punues. Më tutje vlerësoi se materia që e trajton projektligji për Përgjimet e mbulon kryesisht sektorin e sigurisë, ndërsa ky projektligj iu është adresuar Komisionit për Integritet. Për këtë arsye, kërkoi që të informohemi pse ky projektligj është adresuar në Komisionin për Integritet, pse ka ndodhur kjo, duke ditur rëndësinë e këtij projektligji?

Kryetari- Duke ditur që ka pasur një debat jo të lehtë për projektligjin e përgjimeve, ndoshta edhe të shqetësuar që nuk është marrë mbështetja e deputetëve për të kaluar ky projektligj në

legjislaturën e kaluar, mbase është menduar që në Komisionin për Integritet në këtë legjislaturë do të kalojë më lehtë. Ne mund të kërkojmë informacione nga sekretaria e Kuvendit, edhe pse kjo temë më shumë i takon seancës plenare.

Në fund theksoi se ky projektligj është kthyer nga Komisioni për Integritet për plotësim.

Fadil Demaku- Theksoi se nëse është menduar që të kalojë më lehtë ky projektligj përmes një Komisioni tjetër, konsideroi se kjo nuk i kontribuon punës së legjislativit, ndërsa do duhej të trajtohej nga komisionet që merren me fushën e sigurisë për shkak të procedurës.

Zafir Berisha- Sa i përket projektligjit për përgjimet, theksoi se edhe në mbledhjen kaluar e ka ngritur këtë çështje, pse nuk është adresuar në Komisionin për Siguri, pasi materia të cilën trajton ky projektligj rregullon këtë fushë. Ai shtoi se si deputet dhe përfaqësues të partive politike që i përkasim do duhet ta kthenim në vijë të duhur këtë projektligj.

Propozoi që me pajtimin anëtarëve të Komisionit, javën e ardhshme të jetë në dëgjim publik ministri i Punëve të Brendshme, lidhur me çështjen e një qytetari nga Serbia i cili kishte sasi të eksplozivit, për të cilën gjë më shumë jemi njoftuar përmes mediave.

Të dihet gjendja e sigurisë në çfarë niveli është në Kosovë?

Nuredin Ibishi- Propozoi që përveç kësaj çështje që përmendi Berisha, ministri të raportojë edhe për rastin e protestave që u mbajtën ditën e shtunë, më 24 janar 2015. A ishin të njoftuar për këtë tubim publik dhe të sillt një raport për ngjarjet e kësaj dite, se sa është respektuar ligjshmëria dhe pasojat e kësaj ngjarje.

Kryetari- Propozoi që nëse janë dakord të gjithë anëtarët, në javën tjetër të ftohet ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, datë e mundshme 2 shkurt, në orën 10:00.

Kryetari i njoftoi anëtarët për disa takime që ka realizuar, me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, përfaqësues të vendeve të kuantit dhe nga OSBE-ja. Kryesisht diskutimi mes tyre ka qenë transformimi i FSK-së në Forcë të Armatosura, lidhur me legjislacionin në këtë fushë. Gjithashtu shtoi se kurdo që projektligjet për këtë çështje do të jenë në Komision, ne do të trajtojmë dhe mbështesim këtë proces.

Gjithashtu njoftoi që bashkë me disa nga anëtarët e Komisionit jemi takuar për një drekë pune me Ambasadoren e Gjermanisë në Kosovë dhe ish-komisionarin e Forcave të Armatosura të Gjermanisë z. Reinhold Robbe, ku është ofruar mbështetja e tyre për Projektligjin për Komisionarin për FSK dhe PK.

Po ashtu njoftoi që nesër, më 27 janar, në orën 12:00, do të bëhet nisja për në Pejë, për punëtorinë për shqyrtimin e planit të punës, mbështetur nga OSBE-ja. Me këtë pikë e konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj